



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0304

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj-Mexhuani si paneliste individuale, duke vendosur sipas ankesës së OE SMART ENG GROUP SH.P.K. kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi dhe mirëmbajtja e dyshemeve për IEA” me numër të prokurimit 616-23-1780-5-2-1, iniciuar nga Komunës së Prishtinës, në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK) me 11.07.2023, mori:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e OE SMART ENG GROUP SH.P.K. ushtruar në OSHP me datë 25.05.2023, Protokolli 2023/0304, kurse mbetet në fuqi Vendimi i AK i datës 02.05.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi dhe mirëmbajtja e dyshemeve për IEA”, me numër të prokurimit 616-23-1780-5-2-1.

2. Konfiskohet shuma e mjeteve të depozituara në emrin e tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sikurse parashihet me 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 07.03.2023, Komuna e Prishtinës duke veprua në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë (NJK) për aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi dhe

mirëmbajtja e dysHEMEVE për IEA” evidentuar me numër të prokurimit 616-23-1780-5-2-1.

Me datë 02.05.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin, sipas të cilit ka shpërblyer me kontratë OE Tosi-V SH.P.K.

Me 05.05.2023 OE, SMART ENG GROUP SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datë 15.05.2023.

Me 25.05.2023, OE (me të dhëna si më sipër) i pakënaqur me Vendimin e cituar si më sipër të AK, ka parashtruar ankesë në OSHP, regjistruar me numër protokolli 304/23.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës – punë, vlera e parashikuar e kontratës: 80,000.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak,

Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrroj ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bie nën kompetencat e këtij organi kuptim të nenit 105 të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 01.06.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar;

Të mbetet në fuqi vendimi i AK;

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër është pranuar nga gjitha palët. AK është pajtuar me mendimin e ekspertit ndërsa Operatori ekonomik ankues nuk kanë dhënë mendim rreth raportit të ekspertit. Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me nenin 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Në këtë rast, duke u bazuar në administrimin e gjitha provave dhe shkresave të kësaj lënde, Paneli mori në konsideratë të gjitha faktet dhe provat të cilat trajtohen si të tilla nga pohimet e ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe analizat e ekspertit shqyrtues dhe duke i veçuar në ato më relevante, së pari konstatoi se sipas Ankuesit, AK ka shkelur dispozitat e neneve 1, 7, Neni 131, të LPP, sepse (sipas tij/sajë) me qëllim e ka ngarkuar para-masën me gabime aritmetike për qëllime favorizimi të operatorëve tjerë ekonomik. Lidhur me këtë

Lidhur me këtë, Paneli vëren se eksperti shqyrtues i ka shqyrtuar në këtë rast me kujdes dhe në hollësi pohimet ankimore duke i analizuar ato në raport me kërkesat, kushtet, kriteret dhe specifikat e parashikuara në dosjen e tenderit (DT) dhe në njoftim për kontratë (NJK) duke shpjeguar në vijim se sipas paragrafit 1 të nenit 51 të LPP, parashihet se, cituar: "Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji".

Dhe se, hartimi i DT shprehimisht është parashikuar me dispozitën e nenit 27 të LPP dhe mund të konstatohet se e njëjta përbën dokumenti kryesor për të gjitha palët e përfshira në procesin e administrimit me një aktivitet të prokurimit. Dhe për këtë arsye, për çdo paqartësi lidhur me kërkesat, kushtet dhe specifikimet e përcaktuara nga një AK në DT, secili OE ka të drejtë që sipas nenit 53 të LPP të kërkojë sqarime shtesë nga AK, natyrisht brenda afatit ligjor po ashtu të specifikuar në DT. Prandaj edhe ankuesi në këtë rast, ka pasur të drejtë që të kërkojë shpjegime plotësuese, posaçërisht lidhur me Para-masën dhe Para-llogarinë, nëse ka konsideruar se të njëjtat janë publikuar me gabime eventuale (natyrisht pa ndonjë paragjykim). Në të vërtetë, në vështrim të dispozitës së cituar një e drejtë e tillë i garantohet secilit OE, ngase në të njëjtën thuhet, cituar, "Gjatë përgatitjes së tenderit, çdo operatorë ekonomik mund të bëjë kërkesë me shkrim te autoriteti përkatës kontraktues për çfarëdo informate apo sqarim shtesë që operatori ekonomik beson se është e nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e një tenderi përkatës, me kusht që çdo kërkesë e tillë me shkrim të pranohet nga autoriteti kontraktues..."

Pikërisht lidhur me këtë, në paragrafin vijues, 4 të nenit 59 të LPP thuhet se, cituar: " Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në

përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit...".sipas nenit 53 të LPP-së ka mundur të kërkoj sqarime shtesë nga AK brenda afatit ligjor të specifikuar në DT. Prandaj bazuar në shpjegimet e cituara shkurtimisht si më sipër konstatohet se Ankuesi nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë, në kuadrin a parashikuar kohor.

- Përfundim –

Paneli shqyrtues pasi shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, diskutimit dhe analizimit të provave në tërësi vlerëson se ankesa e Operatorit ekonomik ankues nuk është e bazuar andaj **Vendimi i atakuar i AK i datës 02.05.2023, mbetet në fuqi.**

Paneli vuri si gjithnjë në zbatim edhe nenin 103 të LPP-së sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një subjekti në procedurë.

Duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - SMART ENG GROUP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: